

VENDIM

“PËR VËNJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR : ARJAN ALIAJ

Asistuar prej sekretare gjyqësore **Denisa Khafa** , sot më datë **30/07/2014**, mori në shqyrtim materialin procedues që i përket :

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, perfaqesuar nga prokuror Alketa Zifla.

OBJEKTI: Venie sekuestro preventive Caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro Preventive”.

Baza Ligjore: Nenet 274/2, 210 të K.Pr.Penale dhe 36 të Kodit Penal.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, provat e paraqitura nga ana e subjektit kërkuar, bazuar në nenet 36 të Kodit Penal, 274 ,210 e 276 të K.Pr.Penale,

VËREN

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vënë në lëvizje Gjykatën e këtij rrethi gjyqësor me kërkesën me objekt e shkak ligjor si më lart. Nga përmbajtja e materialeve shkresore bashkangjitur kërkesës rezulton e provuar se:

Me date 27. 12. 2013, Prokuroria prane Gjykatës se Shkalles se Pare, Tirane, ka regjistruar procedimin penal nr. **7550** per vepren penale: **Mashtrimi ne Pasoja te Renda ndaj Shume Personave**, parashikuar nga neni **143/ 2** i K. Penal.

Nga hetimet paraprake ka rezultuar se me date **02. 11. 2013**, kallezuesi **A.P** ka lidhur kontrate porosie me firmen **DINI – 2009 me administrator shtetasin H.Z.** Objekt I kesaj kontrate ka qene nje apartament banimi qe po ndertohej ne zonen e (.....), Tirane. Kontrata eshte hartuar tek noterja **Mimoza Mustafaj** nderkohe qe kallezuesi ka likuiduar edhe Shumen **prej 29 430 Euro** per

apartamentin me sip. prej rreth 98 m².kallezuesi ka ndjekur punimet nderkohe qe sipas bisedave me administratorin hyrja do te ishte gati ne muajin dhjetor. Rreth 4 – 5 dite perpara kallezimit, kallezuesi ka mesuar se tek pallati ku ai kishte porositur, adminstratori kishte shitur disa here te njejten hyrje. Kur ka shkuar tek apartamenti I tij ka mesuar se hyrja e tij I ishte shitur nje personi tjeter me kontrate noteriale nderkohe qe ka qene I pamundur me tej komunikimi me administratorin H.Z.

Te njejtin fakt, ndaj te njejtit person, kane kane kallezuar ne te njejtin material referues **edhe 2 shtetas te tjere** me ndyshime ne sip. *E banimit, datat dhe vendet e lidhjes se kontratave noteriale, marreveshjeve, etj.*

Ne datat 19, 20, 23, 27. 12. 2013 e ne vijim, rreth 30 shtetas te tjere kane kallezuar faktin e mesiperm, pra te shitjes se te njejtës prone, personave te ndryshem prej shtetasit H.Z, I cili megjithë kerkimet nuk është arritur te gjendet.

Per kete arsye, duke qene se behet fjale per shitjen e se njejtës prone disa personave te gjitha kallezimet e regjistruara jane bashkuar ne nje procedim te vetem, per vepren penale: **Mashtrimi me Pasoja te Renda, me shume se 1 here, parashikuar nga neni 143/ 2 I K. Penal** ne ngarkim te shtetasit H.Z.

Nga kerkimet e kryera per kete shtetas ne banesen e tij por edhe ne sistemin TIMS ka rezultuar se i dyshuari nuk gjendet ne banese nderkohe qe rezulton te kete *Dalje per jashte shtetit me date 29. 10. 2013, prej pikes kufitare Qafe – Thane.* Koha e daljes perkon pikerisht edhe me periudhen pas realizimit te kontratave noteriale mes tij si ndertues dhe gjithë kallezuesve.

Nga sa me siper, rezultojne dyshime te arsyeshme dhe te bazuara ne prova se shtetasi H.Z, nepermjet akteve te ndryshme noteriale, si kontrata shitje, porosie, kleringu, ka mashtruar disa persona duke u dhene te njejtin apartament personave te ndryshem, ne kohe te ndryshme.

Ne keto rrethana, organi i prokurorise ka kerkuar informacion ne bankat e nivelit te dyte qe operojne ne Republiken e Shqiperise per llogari bankare ne emer te shtetasit H.Z dhe shoqerise “Dini” shpk.

Nga te dhenat e administruara ka rezultuar se ne emer te shtetasit H.Z dhe “Dini” shpk kane llogari rrjedhese apo kredie bankat: BKT, Veneto Banka, Tirana Bank, Union Bank, Intesa San Paolo Bank, International Camercial Bank dhe Raiffeisen Bank, nderkohe qe nuk rezulton qe subjektet e mesiperm te jene kliente apo te kene llogari brane bankave te tjera.

ZVRPP, Tirane me shkresen e saj nr. 2206 Prot., date 04. 03. 2014, ka konfirmuar regjistrimin e shoqerise “Dini’ Shpk dhe objekteve qe ajo ka patur ne ndertim ne fazen e karabinase. Konkretisht behet fjale per objektin: *Godina Banimi dhe Sherbimi 5 kat + nençati + 1 kat dhe 2 kate bodrum*”, (.....), Komuna Dajt, (Seksioni 1 & 3) faza karabina per Regjistrim Provizor.

Nga adminstrimi I te dhenave te mesiperme ka rezultuar se shtetasi H.Z nga periudha 2009 – 2011, me cilesine e administratoririt te shoqerise “Dini” shpk ka kryer transferta te ndrsyhme te llogarive bankare dhe transaksione te pasurive te paluajtshme te lidhura keto me akte te ndryshme noteriale, ne formen e marreveshjes paraprake, porosi, prenotime, sipermarrje apo kleringu ne dem te subjekteve me te cilet ka lidhur kontrate dhe qe kane kallezuar faktin e mashtrimit ne pasoja te renda prej te kallezuarit H.Z.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga ana e Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, analizoi provat shkresore të paraqitura nga ana e këtij subjekti, në interpretim të kuadrit ligjor procedural penal , vlerëson se kërkesa është e mbështetur në prova e ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

**Gjykata, bazuar në nenet 36 të Kodit Penal, 274,276 e 210 të
K.Pr.Penale**

V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Venien e sekuestros preventive, mbi **te gjitha llogarite bankare** ne emer te shtetasit **H.Z** dhe **shoqerise “Dini” shpk**.
 3. Venjen e sekuestros preventive, mbi **objektin: Godina Banimi dhe Sherbimi 5 kate + nençati + 1 kat dhe 2 kate bodrum**”, (.....) **Komuna Dajt, (Seksioni 1 & 3) faza karabina dhe cdo objekt tjeter te regjistruar ne forme provizore apo Perfundimtare prej “Dini”shpk prane ZVRPP Tirane**.
 4. Per ekzekutimin e ketij vendimi autorizohet **OPGj Florian Celibashi** I cili ngarkohet te mbaje proceverbalet perkates te Ekzekutimit te Vendimit, nje kopje e te cilit tu lihet organeve qe disponojne pasurite e sekuestruara.
 5. Nje Kopje e ketij vendimi ti dergohet per dijeni Zyres se Pergjithshme Noteriale, Tirane me qellim njoftimin e gjithe zyrave noteriale per ndalim te veprimeve noteriale me object pasurite e sekuestruara.
 6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.
- **U shpall sot, në Tiranë, më dt. 30.07.2014.**

SEKRETARE

DENISA XHAFI

GJYQTAR

ARJAN ALIAJ